



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 43

Prishtinë, më 19.11.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Selville Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Doruntinë Maloku dhe Agim Ademaj.

**Munguan:** Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Donika Kadaj-Bujupi, Valdete Bajrami dhe Milena Miliçević.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Blerta Bejtullahu, EUSR/EV Office; Kenan Gashi – Avonet; Liridona Gjemajli – RTV 21; Beadin Sylja- Kosova Press; Alma Tafarshiku – EULEX; Fjolla Uka- KDI; Kaltrina Ahemti – GLPS; Petrit Hysaj – OSBE; Mergime Kajtazi – KDI, Floriana Merovci- ZPRK; Shefki Kastrati – NDI; Afërdita Sylejmani – RTK; Amire Qamili-BIRN; Arta Arifi – Rrokum TV dhe Drilon Asllani – Radio Dukagjini.

**Mbledhjen e kryesoi,** Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 16.09 dhe 13.10.2015;
3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i grupit punues në Projektligjin nr. 05/L-41 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-38 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës;
5. Të ndryshme.

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 16.09 dhe 13.10.2015**

**Kryesuesja** konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 16.09 dhe 13.10.2015, pa vërejtje.

## **3. Shqyrtimi i raportit me amendamente i grupit punues në Projektligjin nr. 05/L-41 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik**

**Kryesuesja** e ftoj kryesuesin e grupit punues, z. Agim Aliu, që ta arsyetojë raportin me amendamente.

**Agim Aliu** tha se siç e dini, si Komision, për herë të dytë po merremi me këtë Projektligj pasi që i njëjti më herët është tërhequr nga Qeveria dhe riproceduar. Si grup punues e kemi shqyrtuar Projektligjin dhe duke mos parë që ka pasur ndonjë ndryshim esencial si grup punues edhe në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe mekanizmat e tjerë ndërkombëtar, jemi pajtuar që të paraqesim para Komisionit këto 9 amendamente. Siç e dini këtij Projektligji i ka paraprirë një fushatë intensive edhe me debate publike dhe vlerësoi se me ndryshimet e bëra Projektligji i ka plotësuar kërkesat e shumicës së palëve dhe si i tillë është një punë e mirë në luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ai falënderoi të gjitha ata që kanë kontribuar në këtë drejtim si shoqërinë civile dhe mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë, me të cilët ne kemi bashkëpunuar. Pastaj tha se edhe si grup, edhe si Komision, dëshira ka qenë që të bëhen ndryshime edhe më të mëdha, por në kuadër të kornizës ekzistuese kemi bërë atë që kemi mundur dhe nuk janë ndryshime të vogla.

**Nezir Çoçaj** kërkoi sqarime nga kryesuesi i grupit në lidhje me përfshirjen e GLPS- së gjatë punës së grupit dhe sa janë marrë parasysh ato propozime që ka sjellë? Sqarime të tilla kërkoi edhe Selvije Halimi pasi tha se kemi marrë disa emaila nga GLPS-ja.

**Agim Aliu** tha se të njëjtat shqetësime i kam marrë edhe unë, por me lejoni të sqaroj se ne me znj. Kaltrina Ahmeti kemi pasur një bashkëpunim të mirë, për çka edhe e falënderoj, pasi që kanë dhënë një kontribut të veçantë në këtë drejtim dhe kanë qenë edhe organizatorë të debatit publik. Më tuje tha se edhe ne, si grup punues, jemi pajtuar se ka nevojë të bëhen ndryshime edhe më të mëdha, por në këtë fazë është e pa mundur që si komision të luajmë rolin e Qeverisë për të ndryshuar më shumë sesa ka kompetencë dhe përgjegjësi ky Komision. Si grup kemi përgatitur 9 amendamente, por që në fakt bëjnë ndryshime shumë të mëdha, të cilat në një formë ose tjetër adresojnë shumë nga shqetësimet e ngritura për këtë Projektligj. Duhet vlerësuar vullnetin e Komisionit pasi që ndryshimet e propozuara nëse vërtet zbatohen do të janë një nismë e mirë për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar. Në vazhdim tha se të njëjtat shqetësime ka paraqitur edhe Bashkimi Evropian dhe Këshilli Evropës. Pas takimit që kisha dhe pas sqarimeve që ju kemi dhënë në lidhje me amendamentet e propozuara, ata ishin të befashuar, për të mirë, pasi që nuk kanë pasur dijeninë se sa ndryshime pozitive janë bërë në këtë Projektligj, e që adresonin edhe shqetësimet e tyre.

**Nezir Çoçaj** propozoj që të dëgjohej znj. Kaltrina Ahemti se çka mendojnë ata për këto ndryshime.

**Selviqe Halimi** para se t'ia kalojë fjalën Kaltërinës tha se sipas Rregullores së Punës së Kuvendit neve na lejohej të bëjmë ndryshime vetëm në dispozita të projektligjit që janë propozuar nga sponzorizuesi. Kjo nuk na ndalon ne të marrim nismën të hartojmë ligj tjetër, por së paku në këtë fazë vlerësoj se ndryshimet janë mjaft substanciale.

**Kaltrina Ahemti, GLPS,** tha se siç e dini ne e kemi bërë një dëgjim publik ku është diskutuar shumë, madje nuk ka qenë vetëm GLPS-ja pjesëmarrës në atë dëgjim publik por kanë qenë edhe shumë organizata të tjera dhe përfaqësues nga Agjencia Kundër Korrupsionit dhe të gjithë kanë qenë të shqetësuar me përmbajtjen e ligjit. Unë e kuptoj se është shumë keq kur fillohet me punuar në diçka që është shumë i mangët. Ne këtu nuk po flasim për detaje, por po flasim për diçka shumë bazike që një ligj duhet të adresojë dhe të jetë në përputhje me standardet e BE-së, e që nuk është. Në raport të progresit thuhet se ky ligj duhet të ndryshohet dhe çka nëse nuk ndryshohet? Qëndrimi ynë ka qenë që Projektligji t'i kthehet Qeverisë dhe të ndryshohet në mënyrë drastike. Ndryshimet e grupit janë të mira, por janë shumë pak në krahasim me atë se çka do të duhej të ndryshohej. Do të ishte mirë që të mbahen edhe dy apo tri takime që të shikohet mundësia e ndryshimeve të tjera, sepse me një takim të grupit është shumë pak që të adresohen çështjet.

**Agim Aliu** në fjalën e tij të serishme tha se vetë fakti që ju dhe edhe fjala Kaltërinës në Komision tregon edhe vullnetin që kemi pasur. E thashë edhe më herët se edhe ne pajtohemi me disa nga vërejtjet, por që nuk na lejojnë procedurat në Kuvend për të bërë më shumë. Duhet ta keni parasysh që Projektligji ka pasur 15 nene dhe ne kemi bërë 9 amendamente dhe atë shumë supstancale, tash nuk mund të bëjmë ligj të ri. Esenca e gjitha propozimeve të GLPS-së ka qenë të tërhiqet Projektligji dhe ne nuk dëshirojmë të tërhiqemi, sepse dëshirojmë të avancojmë para. Vlerësoj se tërheqja e Projektligjit do të ishte një hap prapa në luftë kundër krimit dhe korrupsionit, për faktin se nuk e dimë pastaj në cilën legjislaturë do të sillet një ligj i ri. Nuk ka qenë e lehtë të bëhen as këto 9 amendamente, sepse ka qenë tejkalim i kompetencës, andaj duhet ta çmoni vullnetin e grupit punues dhe të këtij komisioni sepse na bashkon një pikë, pra lufta kundër dukurive të këqija. Kurse sa i përket asaj që ligji nuk është në pajtim me standardet ndërkombëtare, unë e thashë edhe më herët se jam takuar me Jouni Lehtimaki, ekspert legjislativ i Bashkimit Evropian, i cili është pajtuar dhe ka pëlqyer punën e grupit punues. Andaj, nuk e di kush do të duhej të fliste në emër të tyre? Vlerësoj se GLPS-ja nuk e ka këtë të drejtë të flasë në emër të tyre, sepse ne jemi takuar me ta dhe kemi marrë vlerësimin pozitiv. Në fund tha se ky është hapi parë në këtë drejtim dhe ne do të vazhdojmë edhe më tutje, sepse siç e dini ne kemi diskutuar që të marrim nismë legjislative për të hartuar ligj të ri për parandalimin e konfliktit të interesit, por në këtë fazë kjo është e tëra që kemi mundur të bëjmë dhe vlerësoj se është bërë punë e mirë dhe kërkoj që të përkrahni këto amendamente.

**Kryesuesja** tha se grupi punues nuk e ka përfunduar punën me një takim, por e dini që janë mbajtur disa takime para se Projektligji të tërhiqet nga propozuesi dhe shumica amendamenteve janë përkrahur përsëri.

**Agim Ademaj** tha se edhe grupi punues që ka punuar më herët para se ky Projektligj të tërhiqet dhe të riprocedohet ka pas një konsensus që të procedohet me këto ndryshime. Pra këto ndryshime nuk kanë dalë nga një takim, por ky Projektligj ka një histori deri te këto ndryshime.

Pas gjithë asaj pune me të gjithë aktorët kemi ardhur me një konsensus të plotë dhe i kemi propozuar po ato amendamente, të cilat kanë qenë edhe më herët. Më tutje tha se edhe ky grup ka punuar me përkushtim dhe ka konsultuar të gjithë aktoret dhe pas ati takimi që kemi pasur kam munduar se kemi pasur edhe pajtimin e GLPS-së. Tani po del që ata nuk janë të kënaqur dhe unë kam marrë edhe mesazh në telefon nga Kaltërina dhe kjo formë e komunikimit nuk është e mirë sepse janë grupet punues ku i kemi shterur debatet.

**Doruntinë Maloku** tha se amendamentet duhet të procedohen për seancë sepse edhe ashtu puna e këtij Projektligji është stërzgatur pasi që morëm sqarimet e nevojshme nga kryesuesi grupit që ka mbajtur takime edhe me përfaqësuesit e BE-së dhe nuk ka ndonjë dilemë.

**Agim Aliu** tha se duhet ta kemi parasysh edhe një fakt pasi që bëhet fjalë për 1.500 raste të konfliktit të interesit, për 1.500 vende pune, pra kjo është gama e këtyre amendamenteve. Për këtë arsye thashë se amendamentet janë përmbajtjesore ku miratimi i tyre praktikisht do të hap 1.500 vende punë pasi që 1.500 persona nuk mund të mbajnë më ato pozita që i kemi përfshirë si konflikt interesi.

*Meqë nuk kishe diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:*

### **P ë r f u n d i m**

- I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit;
- II. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim sipas kompetencës në komisionet kryesore;
- III. Amendamentet e miratuara janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali.

#### **4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-38 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës**

**Kryesuesja** paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-38 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

*Meqë nuk kishte vërejtje, Kryesuesja konstatoi se komisioni në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:*

### **Rekomandim**

1. Projektligji nr. 05/L-38 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t’i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

## **5. Të ndryshme**

Komisioni vendosi që mbledhja e radhës të jetë më 30.11.2015, në orën 11:00.

Mbledhja përfundoi në orën 14:45.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit,

---

**Selvije Halimi**

**Aneks- Amendamentet e miratuara për Projektligjin nr. 05/L-41 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-51 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

#### **Amendamenti 1**

Në tërë tekstin e Projektligjit, pas fjalës “**ligjit**” shtohet fjala “**bazik**”, në rastet kur i referohet ligjit bazë.

#### **Amendamenti 2**

**Në nenin 4 të ligjit bazik pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri si vijon:**

“ 3. Në ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, përfshihet edhe kategoria e zyrtarëve të lartë publikë të përcaktuar sipas ligjit nr. 04/L-228 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.”

#### **Amendamenti 3**

**Neni 3** i Projektligjit hiqet dhe renditja e neneve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

#### **Amendamenti 4**

**Neni 4** i Projektligjit **hiqet** dhe renditja e neneve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

#### **Amendamenti 5**

**Neni 5** i Projektligjit **hiqet** dhe renditja e neneve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

#### **Amendamenti 6**

**Neni 8** i Projektligjit ndryshohet si vijon:

” Neni 12, paragrafi 2 i ligjit bazik riformulohet si në vijim:

2. Nëse ndaj zyrtarit të lartë gjatë dhe lidhur me ushtrimin e funksionit publik ushtrohet ndikim i drejtpërdrejt apo i tërthortë, haptazi apo në mënyrë anonime për të votuar apo për të marrë vendim konkret, ai njofton me shkrim institucionin që e ka zgjedhur apo emëruar si dhe Agjencinë e cila pas shqyrtimit do të vendosë nëse ka bazë të lajmërohen organet e ndjekjes.

#### **Amendamenti 7**

Në nenin 10 të Projektligjit, hiqen fjalët “*Në nenin 15 të ligjit bazik, paragrafi 1, pas fjalës ndërmarrjeve private, shtohen fjalët “në qoftë se ndërmarrja e tillë ka kontratë apo përfiton*

*ndihmë nga Institucioni, në të cilat zyrtari i lartë është në pozitë vendimmarrëse.”*, pjesa tjetër mbetet si në Projektligj.

## **Amendamenti 8**

Neni 11 i Projektligjit ndryshohet si vijon:

### **“Neni 16 i ligjit bazik ndryshohet si vijon:**

“1. Zyrtarët e lartë publikë nuk mund të jenë menaxhues, kontrollues apo anëtarë të organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse; përjashtuar subjektet politike, funksionet e përcaktuara në nenin 15, paragrafin 2 të ligjit bazik si dhe rastet kur një funksion i tillë dedikohet për shkak të funksionit.

2. Zyrtari i lartë publik nuk mund të ushtrojë veprimtari private, si atë të avokatisë, noterisë, përmbaruesit privat, ekspert të licencuar, konsulent, agjent apo përfaqësues të organizatave të përcaktuara në paragrafin 1, të këtij neni.

3. Zyrtari i lartë publik, nuk mund të ushtrojë në mënyrë aktive të drejtën e pronësisë ose pjesë të pronësisë në një ndërmarrje, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj.

4. Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë më shumë se një funksion në sektorin publik, përveç rasteve sipas detyrës zyrtare, si dhe nuk mund të jetë anëtar i bordit të ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura.

5. Përjashtim nga paragrafi 4, i këtij neni bëjnë rastet e përcaktuara në nenin 10.2 të ligjit bazik.”

## **Amendamenti 9**

Në neni 14 të Projektligjit, paragrafi 1, në rreshtin e parë hiqet fjala “ **ushton**” dhe zëvendësohet me fjalën “**paraqet**”, kurse në rreshtin e katërt, pas fjalëve “**e që**” shtohen fjalët “**mund të**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 2, në rreshtin e parë hiqet fjala “ **procedimin**” dhe zëvendësohet me fjalën “**procedurën**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Paragrafi 3, në rreshtin e parë hiqet fjala “ **procedimin administrativ dhe/ose**” dhe zëvendësohet me fjalën “**procedurën administrative ose gjyqësore**” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.